



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

**SHPLLJE PËR NËPUNËS CIVIL,
LËVIZJE PARALELE DHE PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL NË KATEGORINË
EKZEKUTIVE**

Në zbatim të nenit 22 dhe të nenit 25, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe të kreut II, IV dhe VII, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.243, datë 18.03.2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, i ndryshuar, njësia përgjegjëse pranë Komisionit të Prokurimit Publik shpall procedurën e lëvizjes paralele, dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive për pozicionin:

1. “Specialist Financë” në Sektorin e Financës, Burimeve Njerëzore dhe Trajnimeve në Drejtorinë e Monitorimit Shërbimeve Mbështetëse dhe Financës në Komisionin e Prokurimit Publik - Kategoria: III-b, një vend vakant.

Pozicioni më sipër, i ofrohen fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele! Vetëm në rast se në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se pozicioni është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurrimin nëpërmjet procedurës së pranimin në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive.

Për të dy procedurat (lëvizje paralele dhe pranim në shërbimin civil) aplikohet në të njëjtën kohë!

Afati për dorëzimin e dokumenteve:	Shih procedurat përkatëse
Deri në 07.07.2023	Lëvizja paralele
Deri në 12.07.2023	Pranim në shërbimin civil

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin më sipër është:

1. Të kryej mbajtjen e sistemit kontabël, pasqyrave financiare duke pasqyruar veprimtarinë ekonomike-financiare, situacionet mujore të shpenzimeve dhe të të ardhurave si dhe të pasqyrave financiare vjetore si dhe çdo proces tjetër sipas akteve ligjore përkatëse.
2. Përgatit urdhrat e brendshëm për kthimin e tarifave të operatoreve ekonomike ankimues duke kryer funksion teknik në funksion të veprimtarisë së institucionit.
3. Të hartojë planin ekonomik – financiar të institucionit dhe ndjek zbatimin e tij në përputhje me legjislacionin në fuqi.
4. Mban regjistrin e riskut, vlerëson, kontrollon risqet që vënë në rrezik arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive të strukturave që ata drejtojnë.

5. Përgatit dhe paraqet pranë Degës së Thesarit dhe bankave të nivelit të dytë, të urdhër shpenzimet dokumentacionin justifikues për realizimin e pagesave lidhur me transaksionet financiare të kryera, në përputhje me limitet mujore të miratuara.
6. Përgatit situacionet e shpenzimeve dhe rakordon çdo muaj me Degën e Thesarit.
7. Përpilon dhe lëshon “Faturë për Arkëtim”, për çdo operator ekonomik që dorëzon ankesë në institucion.
8. Evidenton gjendjen e magazinës, lëvizjen e vlerave monetare dhe materiale në përputhje me dokumentacionin përkatës dhe legjislacionin në fuqi.
9. Merr pjesë në hartimin e buxhetit vjetor dhe propozon parashikime për një menaxhim optimal të tij.
10. Llogarit pagat, dhe përpilon urdhër shpenzimet për to.
11. Llogarit tatimet, sigurimet dhe realizon detyrat teknike.
12. Kryen detyra të tjera dhe procese të tjera pune që lidhen me fushën e veprimit të sektorit, sipas urdhrit të Përgjegjës të Sektorit apo eprorit direkt.

I-Lëvizja paralele

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil.

1.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar, brenda së njëjtës kategori për të cilën aplikon (kategoria III-b;
- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi (të vërtetuar me një dokument nga institucioni);
- Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “Mirë” apo “Shumë mirë”;
- Të plotësojë kriteret e veçanta të përcaktuara në shpalljen për konkurrim;

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

Arsimimi:

Të zotërojnë minimumi diplomë të nivelit “**Master Profesional**” në **Shkenca Ekonomike**. Edhe diploma e nivelit “Bachelor” të jetë në të njëjtën fushë; **një vend vakant.**

Përvoja:

Të ketë 1 (një) vit eksperiencë pune në profesion.

Tjetër:

- Të ketë njohuri të mira të praktikave të administratës publike, përfshirë përcaktimin e synimeve, hartimin, zbatimin dhe vlerësimin e programeve, menaxhimin e projekteve dhe mbikqyrjen e stafit;
- Të ketë aftësi për shkëmbyer ide dhe mendime teknike dhe për të argumentuar propozimet përkatëse;

- Të jetë i/e aftë të përpilojë, analizojë dhe përgatisë raporte, urdhëresa dhe të dhëna teknike që lidhen me fushën e veprimtarisë;
- Të ketë njohuri të programeve dhe aplikacioneve bazë të kompjuterit;

1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë zyrës së protokollit të Komisionit të Prokurimit Publik, **dokumentet origjinale (ose të njehësuar me origjinalin)** si më poshtë:

- 1) Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në lidhjen <http://dap.gov.al/vende-yakante/udhezime-dokumenta/219-udhezime-dokumenta;>
- 2) Kërkesë për të konkurruar në pozicionin e shpallur, duke specifikuar llojin e procedurës së rekrutimit për të cilin po aplikohet;
- 3) Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën Bachelor). Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë, të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë;
- 4) Fotokopje të librezës së punës (të gjithë faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- 5) Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- 6) Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- 7) Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
- 8) Letër motivimi për aplikim në vendin vakant;
- 9) Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;
- 10) Aktin e emërimit si nëpunës civil;
- 11) Vërtetimin ku specifikohet kategoria e pagës në pozicionin aktual që ushtron kandidati;
- 12) Vlerësimin e fundit nga eprori direkt; (vlerësim të 6-mujorit të fundit dhe vlerësim të pjesshëm (deri në momentin e aplikimit));
- 13) Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi, i cili duhet të jetë i muajit të aplikimit;
- 14) Të dorëzojnë dokumentet e parashikuara në pikën 1.2.

Mosparaqitja e plotë e dokumenteve të sipërcituara, sjell skualifikimin e kandidatit.

Dokumentet duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në institucion, brenda datës 07.07.2023, në Zyrën e Protokollit të Komisionit të Prokurimit Publik, Blv “Dëshmorët e Kombit”, Pallati i Kongreseve, Kati i parë, Tiranë.

1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **11.07.2023**, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore (Njësia Përgjegjëse) pranë Komisionit të Prokurimit Publik, do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen zyrtare të KPP-së, dhe në stendat e informimit të publikut, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet

e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista. Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga Njësia Përgjegjëse e institucionit, nëpërmjet adresës së e-mailit, për shkaqet e moskualifikimit.

Ankesat nga kandidatët paraqiten në Njësinë Përgjegjëse brenda 3 (tre) ditëve pune nga shpallja e listës dhe ankuesi merr përgjigje brenda 5 (pesë) ditëve pune nga data e depozitimit të saj.

1.4

FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- Ligji nr. 8417, datë 21.10.1998, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Ligji nr. 44/2015 Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë;
- Kodi i Procedurës Civile, i ndryshuar;
- Ligji nr.162/2020 “Për prokurimin publik”;
- Ligji nr.49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar;
- Ligji nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar;
- Ligji nr.8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”;
- Ligji nr.125/2013 “Për konçesionet dhe partneritetin publik privat”, i ndryshuar;
- Ligji nr.9874, datë 14.02.2008 “Për ankandin publik”, i ndryshuar;
- Ligji nr.10304, datë 15.07.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr.36/2020 “Për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë”;
- Vendimi nr.285, datë 19.05.2021 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar;
- Vendimin nr.575, datë 10.07.2013 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/partneritet publik privat”, i ndryshuar;
- Vendimin nr.1719, datë 17.12.2008 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të ankandit publik”, i ndryshuar;
- Vendimi nr.320, datë 21.4.2011 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e procedurave e të kriterëve të konkurrimit dhe të afateve të shqyrtimit të kërkesave për marrjen e lejeve minerare në zonat konkurruese”, i ndryshuar;
- Vendimi nr. 401, datë 13.05.2015 i Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj në një procedurë ankimimi ndaj procedurave të koncesionit/partneritetit publik privat, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”;
- Vendimi nr.766, datë 13.10.2021 “Rregullorja për organizimin dhe funksionimin e KPP-së”;
- Ligjit për Sigurimet Shoqërore dhe Shëndetësore të Republikës së Shqipërisë,
- Ligjin e Tatim-Taksave në Republikën e Shqipërisë,
- Ligjin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin,
- Ligjin për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë

1.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar:

Kandidatët do të vlerësohen nga Komiteti Ad-hoc i Pranimit për Lëvizje Paralele, i ngritur në KPP, nëpërmjet dokumentacionit të dorëzuar dhe intervistës së strukturuar me gojë. Totali i pikëve të vlerësimit të kandidateve është 100 pikë, të cilat ndahen përkatësisht:

- **Kandidatët do të vlerësohen për përvojën**, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe certifikimin pozitiv ose për vlerësimet e rezultateve individuale në punë në rastet kur procesi i certifikimit nuk është kryer. Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë.
- **Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:**
 - a- njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
 - b- eksperiencën e tyre të mëparshme;
 - c- motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.Totali i pikëve për këtë vlerësim është 60 pikë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr.2, datë 27.03.2015, “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur”, të Departamentit të Administratës Publike [www.dap.gov.al](http://dap.gov.al) në lidhjen <http://dap.gov.al/2014-03-21-12-52-44/udhezime/426-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>.

Komisioni në përfundim të vlerësimit, njofton individualisht kandidatët që kanë konkuruar për rezultatin e tyre. Kandidatët kanë të drejtë të bëjnë ankim me shkrim në Komisionin e Brendshëm Ad-Hoc për Lëvizjen Paralele për rezultatin e vlerësimit, brenda 3 (tre) ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual mbi rezultatin. Ankuesi merr përgjigje brenda 3 (tre) ditëve kalendarike, nga data e përfundimit të afatit të ankimit. Komisioni brenda 24 (njëzetë e katër) orëve pas përfundimit të procedurave të ankimit, përzgjedh kandidatin, i cili renditet i pari ndër kandidatët që kanë marrë të paktën 70 pikë.

1.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Njësia Përgjegjëse e Komisionit të Prokurimit Publik do të shpallë fituesin në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen zyrtare të KPP-së. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për datën e saktë të shpalljes së fituesit.

2- PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL NË KATEGORINË EKZEKUTIVE

Vetëm në rast se nga pozicioni i renditur në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurrimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive.

Këtë informacion do ta merrni në faqen e KPP-së, pas datës 11/07/2023.

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët jashtë sistemit të shërbimit civil, që plotësojnë kërkesat e përgjithshme sipas nenit 21, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

2.1 Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e pranimi në shërbimit civil dhe kriteret e veçanta:

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e pranimi në shërbimit civil janë:

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

Arsimimi:

Të zotërojnë minimumi diplomë të nivelit “**Master Profesional**” në **Shkenca Ekonomike**. Edhe diploma e nivelit “Bachelor” të jetë në të njëjtën fushë; **një vend vakant.**

Përvoja:

Të ketë 1 (një) vit eksperiencë pune në profesion.

Tjetër:

- Të ketë njohuri të mira të praktikave të administratës publike, përfshirë përcaktimin e synimeve, hartimin, zbatimin dhe vlerësimin e programeve, menaxhimin e projekteve dhe mbikqyrjen e stafit;
- Të ketë aftësi për shkëmbyer ide dhe mendime teknike dhe për të argumentuar propozimet përkatëse;
- Të jetë i/e aftë të përpilojë, analizojë dhe përgatisë raporte, urdhëresa dhe të dhëna teknike që lidhen me fushën e veprimtarisë;
- Të ketë njohuri të programeve dhe aplikacioneve bazë të kompjuterit;

2.2 Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë zyrës së protokollit të Komisionit të Prokurimit Publik, dokumentet origjinalë (ose të njehësuar me origjinalin) si më poshtë:

- 1) Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në lidhjen <http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-dokumenta/219-udhezime-dokumenta;>
- 2) Kërkesë për të konkurruar në pozicionin e shpallur, duke specifikuar llojin e procedurës së rekrutimit për të cilin po aplikohet;

- 3) Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën Bachelor). Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë, të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë;
- 4) Fotokopje të librezës së punës (të gjithë faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- 5) Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- 6) Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- 7) Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
- 8) Letër motivimi për aplikim në vendin vakant;
- 9) Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;
- 10) Vlerësimin e fundit nga eprori direkt; (vlerësim të 6-mujorit të fundit dhe vlerësim të pjesshëm (deri në momentin e aplikimit));
- 11) Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi, i cili duhet të jetë i muajit të aplikimit;
- 12) Të dorëzojnë dokumentet e parashikuara në pikën 2.2.

Dokumentet duhet të dorëzohen me postë apo dorazi në institucion, brenda datës 12.07.2023. në zyrën e Protokollit të Komisionit të Prokurimit Publik, Blv “Dëshmorët e Kombit”, Pallati i Kongreseve, Kati i parë Tiranë.

Mosparaqitja e plotë e dokumenteve të sipërcituara, sjell skualifikimin e kandidatit.

2.3 Rezultatet për fazën e verifikimit paraprak

Prej datës **14.07.2023**, njësia e burimeve njerëzore të institucionit do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen zyrtare të internetit të KPP-së, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta për procedurën e pranimit në kategorinë ekzekutive, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista.

Duke filluar prej së njëjtës date kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta për procedurën e pranimit në kategorinë ekzekutive do të njoftohen individualisht nga njësia e burimeve njerëzore të institucionit nëpërmjet adresave të e-mail, për shkaqet e moskualifikimit.

2.4 Fushat e njohurive, aftësitë dhe cilësitë mbi të cilat do të zhvillohet testimi

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- Ligji nr. 8417, datë 21.10.1998, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Ligji nr. 44/2015 Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë;
- Kodi i Procedurës Civile, i ndryshuar;
- Ligji nr.162/2020 “Për prokurimin publik”;
- Ligji nr.49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar;

- Ligji nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar;
- Ligji nr.8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”;
- Ligji nr.125/2013 “Për konçesionet dhe partneritetin publik privat”, i ndryshuar;
- Ligji nr.9874, datë 14.02.2008 “Për ankandin publik”, i ndryshuar;
- Ligji nr.10304, datë 15.07.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr.36/2020 “Për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë”;
- Vendimi nr.285, datë 19.05.2021 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar;
- Vendimin nr.575, datë 10.07.2013 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/partneritet publik privat”, i ndryshuar;
- Vendimin nr.1719, datë 17.12.2008 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të ankandit publik”, i ndryshuar;
- Vendimi nr.320, datë 21.4.2011 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e procedurave e të kritereve të konkurrimit dhe të afateve të shqyrtimit të kërkesave për marrjen e lejeve minerare në zonat konkurruese”, i ndryshuar;
- Vendimi nr.401, datë 13.05.2015 i Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj në një procedurë ankimimi ndaj procedurave të koncesionit/partneritetit publik privat, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”;
- Vendimi nr.766, datë 13.10.2021 “Rregullorja për organizimin dhe funksionimin e KPP-së”;
- Ligjit për Sigurimet Shoqërore dhe Shëndetësore të Republikës së Shqipërisë,
- Ligjin e Tatim-Taksave në Republikën e Shqipërisë,
- Ligjin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin,
- Ligjin për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr.2, datë 27.03.2015, “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur”, të Departamentit të Administratës Publike [www.dap.gov.al](http://dap.gov.al) në lidhjen <http://dap.gov.al/2014-03-21-12-52-44/udhezime/426-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>.

Komisioni në përfundim të vlerësimit, njofton individualisht kandidatët që kanë konkuruar për rezultatin e tyre. Kandidatët kanë të drejtë të bëjnë ankim me shkrim në Komisionin e Brendshëm Ad – Hoc për procedurën e pranimin në shërbimin civil për rezultatin e vlerësimit, brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual mbi rezultatin. Ankuesi merr përgjigje brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike, nga data e përfundimit të afatit të ankimit.

2.5 Mënyra e vlerësimit të kandidatëve:

Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është 100, të cilat ndahen përkatësisht:

- a) për vlerësimin e jetëshkrimit (CV) të kandidatëve, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 15 pikë;
- b) për intervistën e strukturuar me gojë, deri në 25 pikë;
- c) për vlerësimin me shkrim, deri në 60 pikë.

2.6 Data e daljes së rezultateve të konkurimit dhe mënyra e komunikimit

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Njësia e Burimeve Njerëzore do të shpallë fituesin në faqen zyrtare të internetit të Komisionit të Prokurimit Publik dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike, për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail).

Adresa: Komisioni i Prokurimit Publik, Blv. “Dëshmorët e Kombit”, Pallati i Kongreseve, Kati I”, Tiranë.